



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**VENDIM**

**Nr. 24/2019**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË  
KONTROLLUAR LIGJSHMËRINË E VEPRIMEVE TË ORGANEVE  
TË PUSHTETIT EKZEKUTIV DHE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA  
SHTETËRORE NË PAJISJEN E Z. GENT CAKAJ ME “CERTIFIKATË TË  
SIGURIMIT TË PERSONELIT” DHE HETUAR NËSE Z. CAKAJ KA PASUR  
QASJE NË INFORMACIONE TË KLASIFIKUARA PA QENË I PAJISUR  
MË PARË ME KËTË DOKUMENT NË CILËSINË E TIJ SI ZËVENDËSMINISTËR  
PËR EUROPËN DHE PUNËT E JASHTME APO DETYRA TË TJERA  
SHTETËRORE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një të katërtës së deputetëve,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh, për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative të organeve të pushtetit ekzekutiv dhe të institucioneve të tjera shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “Certifikatë të Sigurisë” dhe hetuar nëse z. Cakaj ka pasur qasje në informacione të klasifikuara pa qenë i pajisur më parë me këtë dokument, në cilësinë e tij si zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme apo detyra të tjera shtetërore.

II. Ky hetim do të synojë mbrojtjen e sigurisë kombëtare, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

III. Objekti i punës së Komisionit Hetimor është:

1. Verifikimi i ligjshmërisë dhe i veprimeve të institucioneve shtetërore në pajisjen e z. Gent Cakaj me “Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP)”, nga DSIK.

2. Roli i Këshillit të Ministrave, Kryeministrit apo ministrave përgjegjës në ndjekjen dhe zbatimin e procedurave dhe rregullave për garantimin e informacionit “sekret shtetëror” dhe të procedurave për pajisjen e z. Cakaj me CSP.

3. Arsyet e mospajisjes me CSP të z. Gent Cakaj, për 7 muaj dhe verifikimi i pasojave që ka sjellë për sigurinë kombëtare dhe angazhimet e Shqipërisë, si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat për në BE.

4. Verifikimi nëse autoritetet përgjegjëse kanë lejuar z. Cakaj të administrojë dhe përpunojë informacion të klasifikuar, pa qenë më parë i pajisur me “Certifikatë Sigurie”.

IV. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese dhe përcaktimet e ligjit nr. 8457, datë 11.12.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

V. Komisioni Hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

VI. Komisioni Hetimor Parlamentar përbëhet nga 9 anëtarë, si më poshtë:

|                     |                  |        |
|---------------------|------------------|--------|
| 1. Enkelejd Alibeaj | Kryetar          | (PD)   |
| 2. Ermonela Felaj   | Zëvendëskryetare | (PS)   |
| 3. Xhemal Qefalia   | Anëtar           | (PS)   |
| 4. Klotilda Bushka  | Anëtare          | (PS)   |
| 5. Alket Hyseni     | Anëtar           | (PS)   |
| 6. Spartak Braho    | Anëtar           | (PS)   |
| 7. Ervin Salianji   | Anëtar           | (PD)   |
| 8. Xhemal Gjunkshi  | Anëtar           | (PD)   |
| 9. Luan Rama        | Anëtar           | (LSI). |

Kryetari dhe të gjithë anëtarët e Komisionit Hetimor duhet të jenë të pajisur me CSP të kategorisë “sekret”.

VII. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VIII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për sigurimin e informacionit të klasifikuar, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë, të cilët, gjithashtu, duhet të jenë të pajisur me CSP të kategorisë “sekret”.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratar në datën 31.1.2019